



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 221/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani - Kryetare duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "GRANITI SH.P.K." Adresa "Ibrahim Rugova" p.n. Shirokë, Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Inventar për nevojat e Komunës së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në Kontratat e AQP-së" me numër të prokurimit 623-23-1684-1-2-1, iniciuar nga Komuna e Rahovecit, në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK) me 19.05.2023, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar, ankesa e OE "GRANITI SH.P.K." e parashtruar me 19.04.2023 (Protokolli 221/2022) për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Inventar për nevojat e Komunës së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në Kontratat e AQP-së" me numër të prokurimit "623-23-1684-1-2- 1" kurse Vendimi i AK i datës 05.04.2023 për dhënien e kontratës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Anullohet dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit (precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi) në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të LPP dhe në pajtim me paragrafin 3 te nenit 29 të Rregullores së Punës së OSHP.
3. Lejohet kthimi i depozitës së paguar me rastin e parashtrimi të ankesës, kurse Ankuesi ka të drejtë të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 05.04.2023, Komuna e Rahovecit, në cilësinë e AK, ka publikuar Njoftimin për vendimin për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Inventar për nevojat e Komunës së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në Kontratat e AQP-së” me numër të prokurimit 623-23-1684-1-2- 1.

Me 08.04.2023, kundër vendimit të cituar si më sipër të autoritetit kontraktues, operatori ekonomik (tani ankuesi) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar me vendimin e AK të datës 13.04.2023.

Me 19.04.2023, kundër vendimit të cituar si më sipër të autoritetit kontraktues, operatori ekonomik OE “GRANITI SH.P.K.” nga cilësia e tij si palë e pakënaqur, ka ushtruar ankesë në OSHP (Nr. Protokolli: 221/2023).

Me fazën e shqyrtimit paraprak,

(a) Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 dhe 114, të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 27.04.2023, eksperti e ka dorëzuar Raportin e Ekspertizës me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE të Refuzohet si e pa bazuar ;
- Të vërtetohet njoftimi mbi vendimin për dhënie të kontratës të AK.

(c) Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se, Ankuesi është deklaruar se nuk pajtohet ndërsa AK pajtohet me raportin e cituar. Po ashtu konstatohet paraprakisht, se palët janë në dijeni lidhur me të gjitha shkresat e kësaj lënde, në përbërjen kompletet të sajë sikurse kërkohet në

pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj Paneli konsideron se ka kushte që të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesat e ushtruara në rastin konkret.

Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Paneli konstatoi paraprakisht se nuk ekzistojnë elemente për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj mori në shqyrtim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, ofrojnë prova të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor. Në këtë rast Paneli konstatoi se:

- AK ka aplikuar për këtë aktivitet të prokurimit procedurë të hapur, në harmoni me nenin 32.1 të LPP, duke e përkufizuar llojin e kontratës furnizim, vlera e parashikuar e tenderit 30,000.00 €, përderisa kriteri i dhënies ka qenë tenderi me çmimin më të ultë;
- Ankuesi ka atakuar Vendimin më sipër të AK, për shkaqet dhe arsyet (përmbledhur) si në vijim të këtij arsytimi;

Ankuesi ka pohuar mes tjerash se OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm sipas kriterëve të kërkuara, për arsyet, theksuar shkurtimisht si në vijim: a) nuk e ka prezantuar deklaratën për afatin e validitetit, ndërsa në dosje të tenderit pika 22.1 është specifikuar periudha e vlefshmërisë 90 ditë; b) nuk ka ofertuar konform specifikave teknike të detyrueshme në para masë Nr.8, ku është kërkuar karrige lëvizëse me mbështetëse të krahëve të drurit, duke ofruar karrigen me krah të plastikës/metalit e jo nga druri; c) nuk e ka prezantuar qarkullimin bankar për tre vitet e fundit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,59,60 dhe 69 të LPP;

Paneli Shqyrtues analizoi shkresat e kësaj lënde, pohimet ankimore, veprimet e ndërmarra nga palët dhe shqyrtimin paraprak të ekspertit dhe duke i krahasuar të gjitha ato, konsideron se Raporti i cituar si më sipër i Ekspertit Shqyrtues përmban analiza dhe vlerësime profesionale lidhur me çështjen në rastin konkret dhe se rekomandimet e tija si më sipër tuj janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli në pretendimet si në vijim sepse:

Bazuar në nenin 59 paragrafi 4 i LPP, AK do të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar bashkë me ofertën e tij edhe vlefshmërinë e Tenderit dhe se AK nuk kishte kërkuar as një lloj deklarate për vlefshmëri të tenderit ngase ofrimi i një deklarate të tillë është i pa nevojshme. Sipas paragrafit 3 të nenit 56 të LPP, *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*. Po ashtu Oe i rekomanduar në formularin e tenderit kishte deklaruar se tenderi është valid për një periudhë prej 120 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

Pretendimi ankimor se karriga e ofruar nga OE i rekomanduar për Kontratë nuk i përmbush specifikat e përcaktuar në DT, sipas ekspertit nuk qëndron ngase ne specifikimin e tenderit është përcaktuar qartë në artikullin nr.8, ku është kërkuar: “karrige lëvizëse me mbështetëse të krahëve nga druri” kurse i rekomanduari ka deklaruar se i njëjti përmbush në tërësi specifikat teknike ashtu siç janë kërkuar. Kurse lidhur me këtë pretendim paneli shqyrtues, vlerëson se AK do duhet të kërkojë sqarime nga i rekomanduari për kontratë për dëshmitë e ofruara për këtë artikull në kuptim të nenit 72 dhe 59 të LPP.

Ndërsa sa i përket pretendimit që i rekomanduari nuk ka ofruar qarkullimin bankar ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë por vetëm për vitin 2021. Paneli shqyrtues sqaron se Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë ka ofruar qarkullimin prej 1,106,264.43 Euro dhe bazuar në Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimi Publik, neni 8 pika ii), parashihet se, në rastin kur kërkesa e gjendjes ekonomike dhe financiare i referohet një qarkullimi total prej në tri vitet e fundit dhe Operatori ekonomik përmbush kërkesën e përcaktuar në dokumentet e tenderit në vetëm dy vite apo një vit, konsiderohet se OE ka përmbushur kërkesën minimale.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vlerëson se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit, ekzhaminimit dhe krahasimit të tenderëve, ka vepruar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP.

- Përfundim -

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se raporti i ekspertit shqyrtues përmban një vlerësim profesional dhe të argumentuar të pohimeve të ankuesit dhe gjitha fakteve dhe rrethanave tjera të analizuar si më sipër prandaj rekomandimet e dhëna janë miratuar edhe nga Paneli Shqyrtues i OSHP. Kurse AK ka krijuar bindjen reale dhe gjykimin e pavarur se dokumentacioni dhe oferta e OE të rekomanduar i përgjigjet planifikimit të prokurimit në kuptim të nenit 8, dhe përcaktimit të nevojave që duhen përmbushur sikurse parashihet me nenin 9, të Ligjit për prokurimin publik. Duke u bazuar në kompetencat e OSHP të rregulluara sipas nenit 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër. Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 4 paragrafi 1 pika 1.36, dhe 104 paragrafi 1,117, të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradina Mexhuni



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - "Kuvendi Komunal Rahovec;
- OE - "GRANITI SH.P.K." Adresa Rr. Ibrahim Rugova p.n Vendi Shirokë;
- Arhivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb- faqe të OSHP.